

Kushtet dhe afatet e përdorimit

1. Të përgjithshme

Këto Kushte dhe Afate Përdorimi përbejnë të gjithë Marrëveshjen ndërmjet Jush, Klienti i One Telecommunications (më poshtë referuar si “Klienti” ose “Ju”) dhe One Telecommunications sha (me poshtë referuar si “One” ose “Ne”) në lidhje me përdorimin e dyqanit tonë online, shërbimit Rimbushje online (më poshtë referuar si “Rimbushje Online” ose “Shërbimi”).

Shërbimi Rimbushje Online mundëson rimbushjen e krediti të numrit tuaj me parapagese nëpërmjet faqes së web one.al. Kryerja e procedurës dhe porosisë nëpërmjet këtij website nuk ju ngarkon me detyrime të tjera financiare. Ju do të paguani vetëm vlerën e rimbushjes së porositur.

Kushtet dhe afatet e përdorimit si më poshtë janë krijuar dhe zbatohen për përdorimin dhe aksesimin e kësaj faqe interneti dhe shërbimin që ofron. Duke përdorur shërbimin e ofruar në dyqanin tonë online one.al ju pranoni këto Kushte dhe Afate Përdorimi.

Ju këshillojme t’i lexoni këto Kushte dhe Afate Përdorimi sa herë dëshironi të përdorni shërbimin e ofruar duke qënë se këto Kushte dhe Afate Përdorimi mund të ndryshojnë herë pas here me vendim të One. Kur bëni një rimbushje në faqen tonë, kjo nënkupton se i keni pranuar dhe jeni dakord me këto Kushte dhe Afate Përdorimi.

Përdormi i kësaj faqe interneti është e lejuar për kohësisht dhe ne rezervojmë të drejtën të tërheqim ose ndryshojmë Shërbimet pa paralajmërim. Ne nuk do të jemi përgjegjës në qoftë se për ndonjë arsye ky Website nuk është në dispozicion në çdo kohë ose për çdo periudhë. Ne rezervojmë të drejtën të kufizojmë aksesin në disa pjesë ose në të gjithë faqen.

Shërbimi i rimbushjes online ju ofrohet vetëm me kushtet si më poshtë:

- a. Ju duhet të jeni rezident në Republikën e Shqipërisë dhe të paraqisni të dhëta tuaja të sakta si dhe adresën e banimit;
- b. Duhet të jeni mbi 18 vjec.

2. Kushtet e rimbushjes

Duke plotësuar hapat e parashikuara për të marrjen e një produkti nëpërmjet kësaj faqe ju bëni rimbushjen tuaj sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.

- Rimbushja

Sapo të kryeni një pagese ju do të njoftoheni me anë të një sms drejt numrit që keni rimbushur mbi detajet e rimbushjes dhe kushtet e përdorimit.

- Pagesa

Pasi të keni zgjedhur shumën për të paguar dhe numrin drejt të cilit do të kryeni rimbushjen do të drejtoheni prej faqes tone One.al drejt faqes online të payment gateway partner për të procesuar të dhënat e kartës suaj të kreditit/debitit dhe shumën e zgjedhur për rimbushje.

3. Vlerat e rimbushjes

Çmimet për rimbushjen shënohen në Lekë. Të gjitha çmimet përfshijne tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Vlera minimale për një rimbushje është 100 Leke, kurse vlera maksimale është 10000 Leke për sesion.

4. Ruajtja e të dhënave

Gjeni këtu <http://www.one.al/suport> më tepër informacion në lidhje me mënyrën se si One mund të përdorë informacionin personal që ju keni ofruar gjatë procesit të porosisë tuaj në këtë faqe si dhe hollësitë mbi të drejtat tuaja mbi këtë informacion (ruajtja e të dhënave personale). Duke përdorur këtë faqe ju pranoni se do të jepni vetëm informacion të saktë dhe të plotë kur ju kërkohet.

5. Të drejtat e autorit

Përmbajtja e kësaj faqe interneti mbrohet nga legjislacioni në fuqi për të drejtat e autorit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha të drejtat janë të Rezervuara. Në mënyrë të veçantë, riprintimi i përmbajtjes, duke e bërë përmbajtjen publikisht të aksesueshme, veçanërisht duke e ripostuar në faqe të tjera interneti dhe shërbime në rrjet, duke vendosur kështu një lidhje për tek faqja e One si dhe riprodhimi i përmbajtjes me të gjitha llojet e publikimit të të dhënave, p.sh., CD-ROM, DVD-ROM, etj., qoftë edhe pjesë të përmbajtjes, lejohet vetëm pas aprovimit dhe autorizimit me shkrim nga One. One nuk mban asnjë përgjegjësi mbi përmbajtjen e faqeve të internetit që aksesohen përmes lidhjeve të jashtme dhe për atë përmbajtje që, në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, karakterizohet si përmbajtje e palëve të treta, p.sh., njoftimet mbi të drejtën e autorit ose përmes markës tregtare. Ky kufizim i përgjegjësisë zbatohet edhe për përmbajtjen e palëve të treta që lidhet me këtë faqe interneti.

Shërbimi Rimbushjes online është në pronësi të One; Ju pranoni se titulli dhe të drejtat e plota të pronësisë për Shërbimin do të mbeten nën pronësinë ekskluzive të One dhe Ju nuk do të tentoni të kopjoni, modifikoni, ndryshoni Shërbimin në asnjë mënyre apo të nën-liçensoni apo jepni me qira Shërbimin e Rimbushjes online.

6. Të përgjithshme

Këto kushte dhe afate rregullohen nga legjislacioni shqiptar. Çdo mosmarreveshjeve apo divergjence që mund të lindë lidhur me Marreveshje, përfshirë edhe ndonjë pyetje rreth ekzistencës, vlefshmërisë apo zgjidhjes së parakoshme të saj, apo marrëdhënieve ligjore të vendosura mes paleve, do të zgjidhet nga gjykatat e Tiranës, sipas rregullave të Kodit të Proçedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.